



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 04.prill 2012
Nr. ref.: RK 217/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 112/10

Parashtruesi

Nikollë Kabashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtresit të detyrës së
Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 tetor 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Nikollë Kabashi, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston dekretet e Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, të 25 tetorit 2010, bërë me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për emërimin dhe nominimin e gjyqtarëve të Komunës së Gjakovës.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës, të bëra me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që, siç pretendohet, kanë shkelur nenin 3 [Ndalimi i torturës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të ndryshuar dhe plotësuar me protokollet Nr. 11 dhe 14 (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të vendos masë të përkohshme me të cilën pezullohet ekzekutimi i dekreteve.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Me Urdhrin e Kryetarit Nr.GJR. 112/10, të datës 16 nëntor 2010, gjyqtari Ivan Čukalović u emërua Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari me Urdhrin Nr.KSH. 112/10, emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.
8. Më 20 janar 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është njoftuar për kërkesën. Po të njëjtën ditë, për kërkesën është njoftuar edhe Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës.
9. Më 16 maj 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës u përgjigj se parashtruesi i kërkesës nuk ishte rekomanduar nga ana e Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial që të emërohej në pozitën e gjyqtarit në Komunën e Gjakovës, ngase parashtruesi i kërkesës kishte më pak pikë se kandidatët e tjerë të rekomanduar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.
10. Më 9 qershor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vitin 2009, Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (në tekstin e mëtejme: KPGJP) shpalli konkursin për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.
12. Më 1 prill 2009, parashtruesi i kërkesës aplikoi në KPGJP për pozitën e gjyqtarit.

13. Në vitin 2010, KPGJP e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai nuk ishte rekomanduar për asnjë nga pozitat për të cilat kishte aplikuar në fazën e tretë të përzgjedhjes, ngase kandidatët e tjerë kishin qenë më të suksesshëm (AJP 87907).
14. Më 3 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Kolegjin shqyrtues të KPGJP-së për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 6.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 për Kornizën Rregulative të Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: UA Nr. 2008/2).
15. Më 28 janar 2011, Kolegji shqyrtues i KPGJP nxori vendimin për refuzimin e kërkesës së parashtruesit si të pabazë. Për më tepër, Kolegji shqyrtues i KPGJP-së konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka arritur më pak pikë se sa kandidatët e tjerë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon se përzgjedhja e gjyqtarëve të emëruar në Gjykatën Komunale të Gjakovës nuk është bërë në bazë të rregullave të parapara nga KPGJP-ja. Këto rregulla, sipas të cilave kandidatët nuk përzgjidhen për t'u emëruar si gjyqtarë, janë si vijon:

“ ...

- a. Kandidatët të cilët nuk kanë marrë pjesë në konkurs;
- b. Kandidatët që kanë punuar në sistemin gjyqësor të regjimit të Millosheviqit gjatë viteve 1990-1999;
- c. Kandidatët me dosje të dyshimta;
- d. Kandidatët që janë në prag të pensionimit;
- e. Anashkalimi i kandidatëve që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve duke mos i përzgjedhur ata; dhe
- f. Diskriminimi i kandidatëve, etj.

...”

17. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se i kishte kaluar të tri fazat e përzgjedhjes.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës ankohet se dekretet e Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës, të 25 tetorit 2010, të bëra me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shkelin nenin 3 të KEDNJ.
19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, është e nevojshme që Gjykata së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, si dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
20. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimet në pozita gjyqësore pasi që kandidatët të kenë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të parapara me ligj në pajtim me nenin 108 të Kushtetutës.
21. Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 104.1 dhe 86 (16), i emëron gjyqtarët me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
22. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar në asnjë mënyrë ankesat e bëra sipas nenit 3 të KEDNJ-së, ose në lidhje me të drejtat dhe liritë e tija të garantuara me Kushtetutë, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe

nenin 48 të Ligjit (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

23. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës i cili thotë: “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

24. Parashtruesi i kërkesës kërkon pezullimin e dekretëve sepse ato “janë tërësisht të paligjshme dhe jokushtetuese, dhe njëkohësisht paraqesin shkelje të rëndë të ligjit”, pasi që lejuan emërimin e:

“ ...

- a. Kandidatëve të korruptuar;
- b. Kandidatëve të dyshimtë për vepra penale;
- c. Kandidatëve jokompetent dhe njerëzve të papërvojë; dhe
- d. Kandidatëve që kanë bashkëpunuar me regjimin e Millosheviqit.

...”

25. Si rezultat:

“ ...

- a. Nuk është emëruar asnjë kandidatë nga familjet e dëshmorëve;
- b. Dekretet kanë qenë denigrim dhe fyerje e rëndë e familjeve të dëshmorëve;
- c. Dekretet ishin fyerje ndaj përpjekjeve dhe rezultateve të luftës së popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi;
- d. Dekretet, po ashtu, kualifikuan familjet e dëshmorëve si të “padëshirueshme”; dhe
- e. Nuk pati respekt për procedurat e autoriteteve tjera vendore dhe ndërkombëtare.

...”

26. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 27.1 të Ligjit:

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të riparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”.

Dhe në veçanti rregullit 54(1) të Rregullores së punës, i cili parasheh se, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se kërkesa u konstatua si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës sipas rregullit 54(1) të Rregullores së punës nuk ka të drejtë të kërkojë masa të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović



Prof. Dr. Enver Hasani

